VENDIM
Nr. 807, datë 30.9.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E KULTURËS TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË OBJEKTEVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 11 754.2 M², PJESË E PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM "SHA RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të objekteve nr.16, nr. 17, nr. 18 e nr. 21 dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "sh.a, Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t'u përdorur për vendosjen e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për plotësimin e nevojave institucionale të këtij institucioni.
2. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, sipas planvendosjeve, t'i tjetërsojnë ato apo t'ua japin në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Rdi Rama